



**KOMITETI OLIMPIK  
KOMBETAR SHQIPTAR**

**KORRIK-SHTATOR 2010**

# **KOKSH** *Informacione*

## **24 KORRIK – UDHËTIMI I FLAKES OLIMPIKE NË BERLIN**

Flaka Olimpikë e “Singapor 2010” e ndezur në Olimpiadën Antike bëri ndalesën e saj të parë dhe të vetme Europiane në 24 Korrik në Berlin, Gjermani. Mbi 10000 vizitorë festuan së bashku Ditën Olimpikë Rinore në sheshin Paritzer para Portës së Famshme të Brandeburgut. Sportistë të rinj mishërues të vlerave Olimpikë Rinore dhe përfaqësues të Komiteteve Olimpikë Kombëtare ishin të ftuar në këtë event të gëzueshëm. Të rinjtë pjesëmarrës, në rolin e mbajtësve të pishtarit, e pasuan atë dorë më dorë deri në podiumin para portës së Brandeburgut, ku sportistë elitarë gjermanë ndezën me zjarrin Olimpik sferën e madhe. Shqipëria u përfaqësua me Zv. Presidenten e KOKSH, znj. Ela Tase, Anëtarin e Komitetit Ekzekutiv z. Gëzim Panariti, si dhe nga dy sportistët e rinj : Riselda Selaj – Gjymnastikë dhe Olsian Velia – Ciklizëm.

### **UDHËTIMI I FLAKES OLIMPIKE NË BERLIN**



# AKTIVITETE NE LIDHJE ME SINGAPORIN

## 28 KORRIK – TAKIM ME DELEGACIONIN “SINGAPOR 2010”

Në zyrat e KOKSH u mblodh delegacioni tashmë i konfiguruar pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë Rinore “Singapor 2010” Ai kryesohet nga Shefi i Misionit z. Viron Bezhani, i cili është njëkohësisht edhe Kryetar i Komisionit Teknik të KOKSH. Sportistët e rinj pjesëmarrës do të garojnë në 4 disiplina të ndryshme sportive, përkatësisht:

Julsian Gega	Atletike	M
Julanda Bacaj	Xhudo	F
Marsel Nikaj	Vozitje	M
Reni Jani	Not	F

Pjesëmarrësve në këtë kompeticion të rëndësishëm Olimpik, i pari në llojin e vet, iu shfaq një video promovuese e LOR “Singapor 2010”. Më pas, ata u përshëndetën nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, z. Stavri Bello, i cili u foli të rinjve për rëndësinë e vecantë të këtyre lojrave, fokusi i të cilave nuk është thjesht arritja e rezultateve të larta sportive, por mbi të gjitha përhapja e vlerave dhe frymës Olimpikë tek të rinjtë pjesëmarrës, të cilët në të ardhmen synojnë të kapin majat e performancës duke u shndërruar në sportistë elitare, por mbi të gjitha në frymëzues dhe përcjellës vlerash.

## 3 GUSHT – CEREMONIA GALA E DORËZIMIT TË FLAMURIT

Merastin e nisjes së Delegacionit Olimpik Shqiptar që do të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë Rinore “Singapore 2010”, që do të mbahen në datat 14-26 Gusht 2010, Komitetit Olimpik Kombëtar Shqipëtar organizoi në ambjentet e Hotel Sheraton Ceremoninë Gala të dorëzimit të Flamurit Shqiptar. Gjatë ceremonisë u njohën zyrtarisht anëtarët e Delegacionit Olimpik dhe u prezantuan skedat e sportistëve të rinj që do të përfaqësojnë Shqipërinë në këto Lojra nga moderatori i ceremonisë gazetari i mirënjohur sportiv z. Vladimir Grillo. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello theksoi rëndësinë e përfaqësimit të Shqipërisë në Edicionin e parë të Lojërave Olimpikë Rinore duke thënë se kjo është një ngjarje shumë e rëndësishme dhe shpresëdhënëse për të gjithë sportistët e rinj në të gjithë botën pasi në thelbin e tyre këto lojra kanë edukimin e të rinjve dhe transmetimin e vlerave Olimpikë tek ata. Në emër të KOKSH ai i uroi suksese sportistëve dhe zyrtarëve që të përfaqësojnë me dinjitet Shqipërinë. Për të përshëndetur delegacionin, në ceremoni merrnin pjesë gjithashtu zv.Ministrja e Arsimit znj. Nora Malaj, Z. Indrit Fortuzi, përfaqësues i MTKRS, anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, Sekretar dhe President të federatave sportive, përfaqësues të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të Komisioneve të KOKSH, përfaqësues të Media dhe figura të njohura sportive dhe të gazetarisë sportive.

## HOTEL “SHERATON”, TIRANA





**TRAJNIMI I EKIPIT TË TË RINJVE NË ZYRAT E KOKSH  
PARA NISJES PËR NË SINGAPOR**

## CEREMONITË E HAPJES DHE TË MBYLLJES

Në ceremoninë e hapjes, sipas traditës së Lojërave Olimpikë, zhvillohet “Parada e kombeve”, në të cilin sportistë përfaqësues valëvisin flamurin e tyre kombëtar. Në mes të fishekzjarreve dhe performancave shumëngjyrëshe, të pranishmit në stadiumin “Marina Bay” të Singaporit, u përshëndetën me mesazhe nga sportistë të mirënjohur Ambasadorë të Lojërave Olimpikë Rinore, si: Usain Bolt, Yelena Isinbayeva dhe Michael Phelps. Pas fjalës përshëndetëse të Presidentit të CIO Jacques Rogge, Lojrat u deklaruan zyrtarisht të hapura nga Presidenti i Singaporit S. R. Nathan.

Jo më pak spektakolare ishte ceremonia e mbylljes, e cila ndricoi qiellin e Singaporit me fishekzjarre mbresëlënëse në 26 Gusht. Mbas 12 ditësh kompeticioni të një niveli të lartë sportiv, të rinjtë pjesëmarrës dhe të pranishmit festuan së bashku në një ekzibicion sa tradicional aq dhe modern, vizionin e tyre Olimpik.

## Fakte dhe statistika të LOR “Singapor 2010”

205 Komitete Olimpikë Kombëtare morën pjesë në LOR
3600 sportistë morën pjesë në 26 sporte
1400 zyrtarë morën pjesë
U shpërndanë 1151 medalje
Kina ishte vendi me më shumë medalje të fituara – 34 6 ishte numri më i madh i medaljeve të fituar nga një sportiste ( Tang Yi, 17, notare kineze)
70 ishte numri më i madh i golave në 1 ndeshje hendbolli
( Kore e Jugut 70 – 4 Cook Islands )
Lojërat u mbuluan nga 1200 përfaqësues të medias
Lojërat u ndoqën nga 370, 000 spektatorë
U angazhuan 20 000 vullnetarë vendas dhe ndërkombëtarë.

## EKIPI YNË OLIMPIK NË SINGAPOR.

Shqipëria u përfaqësua në edicionin e parë të këtyre Lojërave me një delegacion të përbërë nga : Viron Bezhani – Shef i Misionit; sportistët :Marsel Nikaj, Julsian Gega, Reni Jani, Julanda Bacaj, dhe anëtarët e delegacionit:Gjergj Ruli, Labo Capo, Vojo Malo. Ekipi Olimpik Shqiptar u angazhua në të gjitha veprimtaritë sportive, edukative dhe kulturore të planifikuara nga organizatorët, dhe arriti këto rezultate në kompeticionet sportive:

**Vozitje - Marsel Nikaj**

**Disiplina barkë me 1 person**

**Renditet i 4 në Finalen B / koha 3:31.61 dhe i 10 në renditjen përfundimtare ndër 48 konkurrentë**

**Atletike - Julsian Gega**

**100m skualifikohet (nisje e parakohshme)**

**Not - Reni Jani**

**50m stil flutur / koha 34:43 / renditja përfundimtare 22 ndër 23 konkures 50m stil i lirë / koha 30:99 sek / renditja përfundimtare 49 ndër 62 konkures**

**Xhudo - Julanda Bacaj**

**Kategoria - 63kg  
Eliminohet në grup**



## 09 SHTATOR - POST – OLIMPADË

Në zyrat e KOKSH u zhvillua konferenca për shtyp “Post-Olimpiadë Rinore” që pasoi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Edicionin e parë të Lojërave Olimpikë Rinore “ Singapor 2010”. Shefi i Misionit Viron Bezhani bëri përpara mediave një resume të përfaqësimit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar në këto Lojra. Ai e përshkroi këtë pjesëmarrje si një kapitull të ri në historinë e Lëvizjes Olimpikë Shqiptare dhe si një eksperiencë frymëzuese jo vetëm për sportistët e rinj, ku të gjithë së bashku përjetuan ëndrrën Olimpikë.



## 24 SHTATOR - Aktivitet promocial për fillimin e kursit ASMC

Një ditë përpara fillimit, në datën 24 Shtator 2010, pranë Hotel Doro City, në praninë e të ftuarve ish pjesëmarrës në KOMPAS I & II, anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, zv.Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtorit të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit, si dhe përfaqësuesve të Federatave sportive anëtare, u zhvillua ceremonia promovuese e fillimit të kursit të ASMC. Në fjalën e Drejtorit të Programit z. Stavri Bello, u theksua rëndësia e vijimit të këtij trajnimi të administratorëve sportivë dhe gjithashtu krijimin e një networku (rrjeti) ku të diskutohen mendime dhe ide, pse jo edhe probleme aktuale mbi aspektet menaxheriale në sport. Më pas Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH ftoi të pranishmit në një koktejl dhe në një anë të sallës pjesëmarrësit e KOMPAS I & II kishin mundësi të rikujtonin dhe komentnin fotografitë nga pjesëmarrjet e tyre në dy kurset.





## 25 SHTATOR – FILLIMI I KURSIT ASMC

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar startoi zyrtarisht Kursin e Avancuar për Menaxhimin në Sport (ASMC - Advance Sport Management Course). ASMC e cila bën pjesë në strategjinë botërore të programit të Solidaritetit Olimpik do të zhvillohet nga KOKSH për periudhën Shtator 2010 – Shtator 2011 pranë ambienteve të Universitetit të Sporteve të Tiranës. Seanca e inaugurimit të kursit u përshëndet nga z. Vejsel Rizvanolli Rektori i UST i cili në fjalën e tij përshëndeti dëshirën e kursantëve për të ndjekur këtë kurs si dhe theksoi domosdoshmërinë e një kualifikimi të vazhdueshëm. Në ditën parë, pas ceremonisë zyrtare të hapjes, u vijua me prezantimin e fasilitatorëve dhe pjesëmarrësve. Një leksion hyrës ishte përgatitur nga Drejtori i Programit të ASMC z. Stavri Bello i cili prezantoi për pjesëmarrësit konceptin, filozofinë dhe strategjinë e ASMC, kushtet e pjesëmarrjes dhe detyrimet. Sic ishte parashikuar në program, kursi vijoi me tre temat e para të kapitullit të parë “Organizimi i një Organizate Sportive Olimpikë”.

**Seksioni 1.1** – Ambienti në të cilin zhvillon veprimtarinë një Organizatë Olimpikë Sportive, u prezantua nga Dr. Arben Kacurri, zv. Rektori i Universitetit të Tiranës.

**Seksioni 1.2** – Karakteri i Organizatave Sportive Olimpikë, u prezantua nga Prof. Dr. Albert Kariqi, Kërkues Shkencor pranë Institutit të Kërkimit Shkencor Sportiv

**Seksioni 1.3** – Parimet e Qeverisjes së Organizatave Sportive, u prezantua nga Prof.As.Dr. Albert Shytaj, Drejtor i Institutit të Kërkimit Shkencor Sportiv.

Për cdo temë, në përfundim të prezantimeve u organizua punë në grupe nga pjesëmarrësit sipas çështjeve të dhëna nga prezantuesit.



## **9 KORRIK – 16 KORRIK** Mbledhje e Bordit AOSH

Bordi Drejtues i AOSH u mbledh në zyrat e KOKSH për të bërë një analizë të punës dhe aktiviteteve të Akademisë Olimpike Shqiptare si dhe u mor në konsideratë ristrukturimi i strukturës së kësaj akademie dhe organeve drejtuese të saj. Në përfundim të mbledhjes së datës 16 Korrik 2010, z. Anesti Qelesi u zgjodh Drejtori i ri i AOSH.

## **8 KORRIK – 29 KORRIK** - Mbledhje KE

Komiteti Ekzekutiv i KOKSH ka zhvilluar mbledhjet e tij të radhës duke patur në qendër të diskutimeve përgatitjet e delegacionit shqiptar për Lojërat Olimpike Rinore “Singapor 2010”. Një pikë tjetër me rëndësi e rendit të ditës ishte përgatitjet për “Londër 2012” si dhe vlerësimi i informacioneve nga mbledhjet e komisioneve.

## **13- 15 SHTATOR** – Mbledhje e Komisionit Teknik të ICMG “Volos 2013”

Në kuadër të përgatitjeve për Edicionin e 17të të Lojrave Mesdhetare në Volos dhe Larisa, Komiteti Ekzekutiv i Komitetit Ndërkombëtar të Lojrave Mesdhetare (ICMG), dhe Komisioni Teknik u mbledhën në Volos në datat 13 – 15 Shtator.

Qëllimi i këtij takimi ishte monitorimi i progresit të bërë në organizimin e Lojrave në 2013, si dhe vizita e ambjenteve ku do të zhvillohen kompeticionet. Në përfundim të takimit u dha një konferencë shtypi e përbashkët në lidhje me këto përgatitje. Sekretari i përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello mori pjesë në këtë takim në cilësinë e anëtarit të Komisionit Teknik të ICMG.



Mbledhja e Komisionit Teknik të ICMG

## 1 SHTATOR: TAKIM ME AMBASADOREN E MBRETËRISË SË BASHKUAR NË SHQIPËRI

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH zhvilloi një takim me Ambasadoren Britanike znj. Fiona McIlwham në kuadër të përgatitjes për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Lojërat Olimpike "Londër 2012". Z. Bello e informoi znj. McIlwham mbi aktivitetin që KOKSH ka zhvilluar në kuadër të projektit "Edukimi Olimpik", i shtrirë ky në të gjitha shkollat e Shqipërisë në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Drejtorinë Arësimore. Gjithashtu u diskutuan strategji të bashkëpunimit të mëtejshëm mes dy institucioneve, për ta bërë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Lojërat Olimpike të Londrës sa më të gjerë e të suksesshme.

## 23 SHTATOR – SEANCË E KAS – ZGJEDHJET NË FSH TAEKWONDO

Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) zhvilloi në 23 Shtator një seancë dëgjimore për padinë e paraqitur në lidhje me Asamblenë e Jashtëzakonshme Zgjedhore të zhvilluar në Federatën Shqiptare të Taekwondos, në të cilën palët e përfshira u morën në pyetje nga kryetari i KAS z. Arben Rakipi.

## 23-25 SHTATOR - TAKIM I LIDERËVE TË EUROPËS QENDRORE DHE JUG-LINDORE,

Bosnje – Hercegovina priti takimin e radhës të liderëve të Europës Qendrore dhe Juglindoren në Sarajevë në datat 23- 25 shtator. Në këtë takim KOKSH u përfaqësua me Anëtarin e Komitetit Ekzekutiv z. Vojo Malo.

Tema kryesore e diskutimeve ishin Lojërat Olimpike Rinore 'Singapor 2010', ku z. Malo ndau eksperiencën e tij si anëtar i delegacionit pjesëmarrës në këto Lojra. Gjithashtu, pika të tjera në rendin e ditës ishin pjesëmarrja në mbledhjen COE në Beograd dhe në mbledhjen ANOC në Acapulco



Mbledhja e KAS mbajtur në zyrat e KOKSH, datë 23 shtator

## **25 SEPTEMBER 2010 – ADVANCED SPORT MANAGEMENT COURSE OFFICIALLY KICKS OFF**

The Albanian National Olympic Committee officially started the ASMC (Advanced Sport Management Course). ASMC, which is part of the global strategy of Olympic Solidarity programs, will be held by NOC Albania for the period of September 2010 – 2011. at the premises of the Tirana Sport University (UST). At the inaugural session, the participants were greeted by Mr. Vejsel Rizvanolli, dean of UST who said: “First of all, I would like to hail the participants’ desire to attend this course, and emphasize the necessity of continuous qualification. Second of all, I want to say how much I appreciate Albanian NOC for the initiative and the efforts to a direction that is little appreciated in today’s sport reality, but which we cannot do without. We, as UST have expressed our readiness following the request of Albanian NOC to interact institutionally with the course and make available all human and physical resources at our disposal, according to the Protocol Agreement we have with Albanian NOC. I believe that the course program submitted by the NOC will be of a different level of formation, benefiting also from the experience of the international lecturers that will join. However, considering the situation that Albanian sport is going through in general, I think that this is at least a model of cooperation and interaction”

On the first day, after the official opening ceremony, it was proceeded with the introduction of the facilitators and the participants.. Program director Mr. Stavri Bello gave an introductory lecture which presented to the participants the concept, philosophy and strategy of ASMC, as well as the terms of participation and its obligations. As anticipated in the program, the course continued with the 3 topics of the first chapter: “Organizing an Olympic Sport organization”

- section 1.1 – the environment in which an Olympic Sport Organization performs its activities – by Dr Arben Kacurri, deputy –dean of UST
- Section 1.2 – the character of the Olympic Sport Organizations- by Prof. Dr Albert Karriqi, scientific researcher at the Sports Science Research Institute.
- Section 1.3 – Principles of Governance of Sport Organizations – by Prof. as. Dr Albert Shytaj, Director of the Sports Science Research Institute.

At the end of the presentations, for each topic, the participants were engaged in group work with reference to the issues presented by the lecturers.

In this first session, we appreciate the participants’ active involvement in discussions and group work. In the next session of the first module which will be on 16 October 2010, the 2 remaining sections of the first chapter will be presented. The guest lecturer invited by NOC Albania for this session will be Mr. Luc Vandeputte. There will also be presentations of case studies by the participants for Module 1.

### **ASMC PROMOTION CEREMONY**

A day before the start, on September 24th, at Doro City Hotel, was organized a ceremony for the promotion of the ASMC course, which gathered former participants of COMPASS 1 & 2, members of the Executive Committee, the deputy-dean of the Sports University, the director of the Sports Science Research Institute, as well as representatives of the member sport federations. Mr. Stavri Bello, Director of the program, in his speech emphasized the importance of the continuation of the training for sport administrators, as well as the creation of a network where they can discuss ideas and opinions, but also treat issues of managing aspects of sport.

Then, the Secretary General of KOKSH invited those present to a cocktail. The participants of COMPAS 1& 2 were able to reminisce and comment at photos of their participation in the 2 courses, which were displayed at the side of the hall.

Adresa: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Rr. “Muhamed Gjollështa”,  
Sheshi “Mustafa K.Ataturk” (ish 21-dhjetori), Tiranë-Albania  
Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602, Fax: +355 4 2240 565  
e-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) / [www.nocalbania.org.al](http://www.nocalbania.org.al)